



Prishtinë: 29.08.2014

Kodi i ZRRE-së: V_647_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1154_06_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 01.07.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 gusht 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit R. K. me shifër DPR 15203 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1154_06_14 i datës 05.06.2014.

Arsyetim

Me datë 08.10.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në KEDS për shkak të mos leximit jo korrekt, pasi që fatura e muajit shtator i është katërfishuar. Pas ankesës së konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 28.10.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit nr. 08195104, dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se gjendja reale në njehsor është: TL=035354 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=013575 kWh (tarifa e ulët).

Me datë 08.11.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit nr. 08195104, dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se gjendja reale në njehsor është: TL=035612 kWh dhe TU=013685 kWh.

Me datë 11.11.2013 Departamenti për Konsumator në KKDFE i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij në arsyetimin se sipas procesverbalit nr. 0519171 të datës 25.10.2013 nevojitet faturim plotësues për faturat pa matje 06/2013 – 09/2013.

Me datë 04.12.2013 Departamenti për Faturim në KEDS i ka dërguar konsumatorit faturën mujore për muajin nëntor 2013 me shpenzim prej 14,579 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 1,666.70€.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 25.11.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 03.06.2014 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që të: i) anulon të gjitha faturat e energjisë elektrike të shifrës DPR – 15203 prej periudhës 06/2013 deri më 11/2013; dhe ii) Anulon



korrigjimin nr. 57731 të datës 08.11.2013 në vlerë prej 1.57€ në shifrën DPR – 15203; iii). korrigjon faturat e energjisë elektrike nga periudha 06/2013 deri më 11/2013 në vlerë prej -326.11€, duke bërë shpërndarjen e shpenzimit nga periudha 06/2013 deri më 11/2013; dhe iv). t'i ofron konsumatorit me shifër DPR – 15203 një marrëveshje pagese prej 12 muajve për diferencën në mes të faturave të energjisë elektrike të korrigjuara si në pikën 3 të këtij vendimi dhe vlerës së korrigjuar prej -326.11€.

Baza e kundërshtimit të konsumatorit të theksuara në ankesë është se faturimi nga KEDS-i ka qenë paushallqysh nga janari 2012 e deri më 01.12.2013 dhe se nuk qëndron fakti se faturimi paushall qëndron nga periudha 06/2013 e deri më 09/2013 pasi që nuk është e mundur shpenzimi prej 1,666€ për katër muaj. KEDS-i edhe përkundër shumë ankesave për kontrollimin e njehsorit elektrik prodhimi ACTARIS nuk janë përgjigjur deri më 14.02.2014 kur kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik. Konsumatori thekson se dyshon në njehsorin dhe se thekson se edhe Prokuroria e Shtetit ka ndaluar vendosjen e njehsorëve KOHLER, pasi që për së paku 60% apo 70% më shumë ka regjistruar energji se shpenzimi real. Konsumatori në fund të ankesës thekson se kërkon nga Bordi që të shqyrton me kujdes ankesën e tij dhe se kërkon që të gjejë shumën e përafërt dhe ta ai borxh pastaj të paguhet me 24 këste mujore pasi që nuk jam në gjendje të paguaj.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se sipas shpenzimeve të energjisë elektrike në shifrën DPR – 15203 nga periudha 05/2013 e deri më 08/2013 konsumatori është faturuar për muaj me fatura të pa matura/paushall me shpenzim prej TL=349 kWh dhe TU=174 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 25.31€, në muajin 09/2013 është faturuar me shpenzim prej 2,767kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 132.74€, në muajin 10/2013 është faturuar me shpenzim prej 1233 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 109.24€, si dhe në muajin 11/2013 konsumatori është faturuar me faturë mujore prej 14579 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 1,666.70€. Bordi po ashtu gjatë analizës së lëndës ka vërejtur se gjendja e shpenzimit në njehsorin elektrike nr. 08195104 e evidentuar në procesverbalin nr. 0489528 të datës 28.10.2013 prej TL=35354 kWh dhe TU=13575 kWh dhe gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në rrjedhën e energjisë elektrike në muajin 10/2013 në njehsorin elektrike nr. 08195104 prej TL=22301 kWh dhe TU=13594 kWh, nuk përputhen dhe se kanë një diferencë prej TL=13503 kWh dhe TU=-19kWh. Nga kjo Bordi konstaton se KEDS-i gabuar me mos lexim të rregullt dhe të saktë konsumatorin me shifër DPR - 15203 për periudhën 05/2013 – 11/2013, dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 të Rregullës për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike dhe me Procedurën e leximit dhe faturimit të konsumatorëve tariforë.

Bordi i ZRRE-së po ashtu konstaton se KEDS-i ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 23 paragrafi 3 të Rregullës për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike pasi që nuk ka korrigjuar konsumatorin për këtë mos lexim të rregullt të konsumatorit, andaj lidhur me këtë konstaton se këtij konsumatori duhet t'i bëhet shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 06/2013 deri më 11/2013 dhe se korrigjim i evidentuar në vendimin e DMK, pra prej -326.11€ është i saktë.

Sa i përket kërkesës së konsumatorit lidhur me atë që t'i ofrohet konsumatorit një kontratë prej 24 muaj, Bordi i ZRRE-së konstaton se për shkak të lehtësimit të pagesës së konsumatorit në 24 këste mujore, pranon dhe kërkon nga KEDS-i që t'i ofrohet konsumatorit një marrëveshje pagese në 24 këste mujore. Pra pika e 4 e vendimit të DMK-së në të cilën theksohet se KEDS-i duhet t'i ofroj konsumatorit një marrëveshje pagese prej 12 muaj të ndryshoj dhe tani t'i ofrohet marrëveshja e pagesës në 24 muaj.



Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1154_06_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar